URDHËR
Nr.11, datë 17.1.2012

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË REJA TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË "BACHELOR" NË "PSIKOLOGJI", "TEKNOLOGJI INFORMACIONI DHE KOMUNIKIMI" DHE "INXHINIERI TELEKOMUNIKACIONI" DHE PROGRAMIN E INTEGRUAR TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË "MASTER I SHKENCAVE" NË "ARKITEKTURË" DHE FILLIMIN E VEPRIMTARISË AKADEMIKE PËR KËTO PROGRAME, PRANË SHKOLLËS SË LARTË PRIVATE "VITRINA", TIRANË

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 44/1 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.608, datë 6.5.2009 "Për licencimin e shkollës së lartë private "Vitrina"",

URDHËROJ:

1. Hapjen pranë shkollës së lartë private "Vitrina", Tiranë, të programeve të reja të studimit të ciklit të parë, që realizohen me 180 kredite, me kohëzgjatje normale 3 vite akademike, në formën e studimit me kohë të plotë dhe në përfundim të të cilave lëshohet diplomë universitare "Bachelor" në:

a) Psikologji;

b) Teknologji informacioni dhe komunikimi;

c) Inxhinieri telekomunikacioni.

2. Hapjen pranë shkollës së lartë private "Vitrina", Tiranë, të programit të ri të studimit të integruar të ciklit të dytë, që realizohet me 300 kredite, me kohëzgjatje normale 5 vite akademike, në formën e studimit me kohë të plotë dhe në përfundim të të cilave lëshohet diplomë universitare "Master i shkencave" në:

a) Arkitekturë.

3. Këto programe studimi, në bazë të vendimeve nr.167, datë 15.4.2011, dhe nr.234, datë 16.9.2011 të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë bashkëlidhur këtij urdhri.

4. Programet e studimit të përcaktuara në pikën 1 dhe 2 të këtij urdhri, fillojnë veprimtarinë akademike në vitin akademik 2011-2012.

5. Shkolla e lartë private "Vitrina" duhet t'i nënshtrohet procesit të akreditimit të këtyre programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

6. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij urdhri.

7. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, sekretari i përgjithshëm, Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë, Drejtoria e Zhvillimit të Arsimit Jopublik dhe shkolla e lartë private "Vitrina", Tiranë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj